

PROCESVERBAL
nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 10.11.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës i kryetarit të Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davodovska Dovleva, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 36-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim procesverbalit nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 6.11.2023.
2. Draft-plani vjetor për kryejën e mbikëqyrjes programore për vitin 2024.
3. Draft-plani vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2024.
4. Draft-programi i punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024 (me Draft-programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Draft-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024)
5. Informacion për mjetet financiare të transferuara për financimin e veprimtarisë radiodifuzive nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informative dhe Administratës, me propozim - Konkluzion.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të EF-EM 90.3-SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shërbimit të pestë programor televiziv (TVM5) të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup, për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

8. Propozim për dhënien e miratimit për zbatim të procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim.
9. Propozim për dhënien e miratimi për zbatim të procedurës për furnizim publik - shërbimi: Shërbim shtypi.
10. Propozim për dhënien e miratimit për zbatim të procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim i mendimit të publikut.
11. Propozim për dhënien e miratimit për zbatim të procedurës për furnizim publik-shërbim: Trajnim i të punësuarve të cilët janë të kyçur në përgatitjen e specifikimeve teknike gjatë zbatimit të furnizimeve publike, me vlerë të caktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.
12. Propozim për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 2 (dy) qasjeve për përdorim në bazën elektronike të rregullave të "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut".
13. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 06.11.2023, me tekstin e propozuar.

Pikat 2, 3 dhe 4

Z. Petrushevski propozoi pikat për Draft-planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore për vitin 2024, Draft-planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative për vitin 2024 dhe Draft-programi i punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024 (me Draft-programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Draft -planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024) të shpjegohen me një hyrje dhe të bëhet një diskutim i përbashkët, ndërsa votimi të bëhet për secilën pikë veç e veç.

Këshilli nuk kishte kundërshtim për propozimin.

Z.Trajçevski tha se shkurtimisht do të japë shpjegim për Draft-planin financiar të Agjencisë për vitin 2024, ndërsa shpjegimin për pikat do ta japë udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr, Magdalena Davidovska Dovleva. Ai shpjegoi se përveç aktiviteteve standarde siç janë zbatimi i mbikëqyrjeve për të cilat Agjencia ka kompetenca ligjore, zbatimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me arsimimin mediatik, bashkëpunimin ndërkombëtar, shumica e aktiviteteve për vitin e ardhshëm do të synojnë ndaj dy cikleve zgjedhore që duhet të mbahen në vitin 2024. Që të gjitha këto aktivitete të realizohen, me Planin financiar për vitin e ardhshëm parashihet që të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të jenë 162.926.961,00 denarë. Nga ana e të ardhurave, të ardhura më të mëdha janë planifikuar të realizohen nga Buxheti i RMV-së, në vlerë prej 63 milionë denarë (sipas shpërndarjes së paraparë me ligj prej 5% të mjeteve për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, të cilat janë në vlerë prej 1% e të ardhurave të realizuara tatimore nga llogaria e

fundit e miratuar e buxhetit). Nga lejet janë planifikuar të realizohen të ardhura në vlerë prej 41 milionë denarë, nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimit elektronik 11 milionë denarë, nga mjetet e transferuara nga vitet e kaluara janë planifikuar 36.926.961,00 denarë, nga faturat tranzite 1 milionë denarë dhe nga Buxheti i RMV-së 10 milionë denarë, të cilat janë mjete të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve të Agjencisë gjatë proceseve zgjedhore në vitin 2024. Për të përballuar plotësisht shpenzimet që janë të planifikuara nga mjetet e grumbulluara nga vitet e kaluara do të transferohen 36.926.961,00 denarë. Në anën e shpenzimeve, shpenzimet më të larta janë në pikën e pagave të llogaritura, ku janë planifikuar mjete në shumë prej 74.727.961,00 denarë, ndërsa në pikën e shpenzimeve për kompensimet e anëtarëve të Këshillit janë planifikuar mjete në shumë prej 11.600.000,00 denarë. Në pikën blerja e pajisjeve janë planifikuar mjete në shumë prej 5.300.000,00 denarë, të cilat janë planifikuar për blerjen e TIK pajisjeve si dhe për furnizimin e softuerit të ri për regjistrin elektronik të rrjetit publik të komunikimit elektronik. Pika e shpenzimeve për energjinë e shpenzuar (energji elektrike dhe ngrohje) në vitin 2024 pritet të arrijë në 10.000.000,00 denarë, e cila është pikë mjaft e lartë në krahasim me vitet e kaluara, para fillimit të luftës në Ukrainë dhe para krizës energjetike, dhe kjo pikë është pothuajse gjashtë herë më e lartë (madhe) në krahasim me vitet e mëparshme. Pika të tjera shpenzimesh me të ardhura më të larta në Draftin për vitin 2024 janë pozicionet e shërbimeve intelektuale në shumë prej 21.307.000,00 denarë, të cilat në pjesën më të madhe janë planifikuar për pagesën e kompensimit për bashkëpunëtorët e jashtëm gjatë kohës së zgjedhjeve në vitin 2024, si dhe mjete të planifikuara për mirëmbajtje për investim të sistemeve të Agjencisë në shumë prej 14.380.000,00 denarë. Propozimi i Draft-planit financiar për vitin 2024 është në shumë më të madhe se plani financiar i miratuar për vitin 2023, i cili ishte 149.830.505,00 denarë, gjegjësisht Plani financiar për vitin 2024 është rreth 13 milionë denarë më i lartë.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, ka sqaruar se Draft-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes së programit i përfshin të gjitha mbikëqyrjet e rregullta programore që janë planifikuar të zbatohen në vitin 2024. Bëhet fjalë për mbikëqyrje që zbatohen mbi punën e 3 grupe subjektsh, transmetuesve, ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës dhe mbi operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Në plan janë cekur qartë për cilat obligime nga ligji bëhet fjalë, janë cekur nenet konkrete nga ligji si dhe periudha kur do të zbatohen. E njëjtë është struktura dhe për Draft-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2024, por këtu bëhet fjalë për dy grupe subjektsh, të transmetuesve dhe botues të medias së shkruar. Po ashtu, dhe në këtë plan janë përcaktuar saktë detyrimet nga ligji që do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes, për cilat subjekte dhe në cilën periudhë të vitit do të zbatohet mbikëqyrja. Në programin për punë janë përfshirë të gjitha aktivitetet që llogariten të realizohen, siç janë aktivitetet që rezultojnë nga ndryshimet në LSHMAAV që hynë në fuqi në korrik, përkatësisht miratimi i akteve nënligjore për të cilat Agjencia ka filluar me përgatitje të caktuara, mirëpo ato do të miratohen vitin e ardhshëm, pastaj një aktivitet shumë i rëndësishëm i Agjencisë për vitin e ardhshëm do të jetë monitorimi i reklamimit zgjedhor, po ashtu si dhe aktivitetet lidhur me përfshirjen sociale, organizimin e rregullt të ditëve të arsimimit mediatik, analiza dhe hulumtime lidhur me mbrojtjen e pluralizmit, ndryshimin e strukturës së pronësisë, përqendrim të paligjshëm mediatik, sigurimin e transparencës së pronësisë dhe të punës së transmetuesve. Ajo shpjegoi se në fund të Programi është dhënë një pasqyrë e saktë e të gjitha aktiviteteve dhe cili sektor është kompetent për realizimin e secilit aktivitet si dhe periudhën e realizimit.

Z. Fidanoski tha se e ka dëgjuar me vëmendje hyrjen për të tre dokumentet dhe pajtohet me konstatimet e deklaruara. Në lidhje me Draft-planet për kryerjen e mbikëqyrjes programore dhe administrative tha se shërbimi profesionalisht i ka përgatitur, dhe kjo vlen edhe për Draft-programin. Për të, krahas monitorimit të dy proceseve zgjedhore, sfidë po aq e rëndësishme është edhe përgatitja dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore dhe të gjitha dokumenteve të tjera që nënkuptonë implementim të ingjencave të reja që ka marrë Agjencia me ndryshimet e fundit ligjore, që në thelb nënkuptonë implementim të Direktivës së rishikuar. Ai pret që këto të jenë sfidë në të cilën Agjencia do të duhet të përgjigjet në mënyrë adekuate dhe beson se kështu do të jetë. Ai pret që të gjitha palët e interesuara në shoqërinë tonë që preken drejtpërdrejt nga kjo temë do të marrin pjesë dhe do të kontribuojnë në mënyrë konstruktive me sugjerimet e tyre se si duhet të duket në mënyrë që të mos vihem në situatë që më tej të ketë paqartësi ose siç ishte në të kaluarën kur janë sjellë akte nënligjore për tema të tjera dhe pyetje të mos ketë vërejtje dhe më pas janë paraqitur situata që ka problem. Në çdo rast, ai beson se ky dokument do të përgatitet në mënyrë kualitative që do të nënkuptojnë implementim real të ndryshimeve ligjore që i përcaktojnë kompetencat e reja të ASHMA-së. Në lidhje me monitorimin e zgjedhjeve, ai tha se na presin zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare dhe pavarësisht nëse do të mbahen në dy apo në një kohë, bëhet fjalë për dy procese të ndara (veçanta) që duhet të realizohen me vëmendje. Deri më tani Agjencia e ka bërë absolutisht në mënyrë profesionale dhe pret që edhe këtë herë të jetë ashtu. Ai beson se Agjencia do të jetë shembull për institucionet e tjera se si funksionon një institucion që ka kompetencat e veta në pajtim me rregullativën zgjedhore dhe si i zbaton ato. Vitin e ardhshëm praktikisht fillon, edhe pse nuk është përmendur, dhe strategjia e re rregullatore 2024-2028, e cila duhet të fillojë të zbatohet, praktikisht fillon vitin e ardhshëm, që do të thotë se do të pritet të merret në fund të vitit. Ai beson se dhe ky dokument, si dhe të gjitha këto të marra në Draft-version, do të sillen në të njëjtin nivel, që deri më tani është nga shërbimi, për nga cilësia dhe profesionalizmi. Ai pajtohet se segment i rëndësishëm është arritshmëria e programeve për personat me aftësi të kufizuara shqisore, përfshirja sociale. Ai beson se vitin e ardhshëm do të respektohet maksimalisht nga transmetuesit dhe do të ketë përqindje më të madhe të arritshmërisë të programeve të tilla. Këtu është dhe arsimimi mediatik, liria e medias dhe e shprehjes, lufta kundër gjuhës së urrejtjes, të gjitha llojet e diskriminimit mbeten gjithmonë sfidë. Deri më tani, vitet e fundit nuk ka pasur shumë raste të tilla, ka pasur përjashtime, por kjo nuk do të thotë se nuk do të ndodhin. Në lidhje me Planin financiar, ai tha se të gjitha gjërat e cekura kërkojnë plan financiar më të lartë (madh), ai beson se nuk do të ketë probleme si në të kaluarën me financimin që vinte direkt nga Buxheti i Shtetit, se do të paguhet të gjitha mjetet që realisht, sipas tij dhe në lidhje me ingjencat e reja nuk janë të mjaftueshme. Ai beson se duhet më shumë për Agjencinë që t'i kryejë ingjencat e saj ligjore, por në këtë moment, duke qenë se financimi është i përcaktuar me ligj, pret që ai të respektohet nga organet shtetërore, nga ata që janë kompetent për t'i dhënë ato mjete dhe se Agjencia me kohë do të marrë mjetet që të mund të kryejë normalisht aktivitetin e saj. Ai mbështeti të tre draft dokumentet.

Z. Petrushevski tha se kishte një vërejtje teknike dhe tri vërejtje për materialin. Vërejtja teknike i referohet hyrjes, sepse në paragrafin e tretë fonti është i ndryshëm nga pjesa tjetër e përmbajtjes, dhe sugjeroi që kjo të korrigohej dhe të harmonizohet me pjesën tjetër të tekstit dhe të kontrollohet edhe një herë i gjithë teksti dhe dokumenti të perfeksionohet teknikisht. Lidhur me vërejtjet e tjera, ai tha se për disa pjesë do të përsëritet me z. Fidanoski, respektimi i Direktivës së BE-së 2018/1808 kërkon përgatitjen e shumë dokumenteve dhe akteve nënligjore gjatë vitit të ardhshëm. Ky do të jetë një aktivitet i gjerë i Agjencisë krahas

aktiviteteve të rregullta. Zgjedhjet, qofshin ato në një mandat apo në kohë të ndryshme, gjithësesi që janë dy lloje zgjedhjesh. Ai nuk e di nëse paratë që i detyrohen Agjencisë janë të ndryshme nëse zgjedhjet janë në të njëjtën kohë ose jo, në çdo rast ky është një aktivitet i madh që do të përfshijë shumë resurse të Agjencisë dhe angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm. Ajo që është mirë dhe që dëshiron të lavdërojë për këtë dhe vitet e kaluara janë aktivitetet për arsimimin mediatik dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, të punësuarit janë shumë të angazhuar dhe kështu duhet të vazhdohet. Sa i përket financave, ai tha se shpreh pak shqetësim sepse që buxheti i Agjencisë është rritur në krahasim me vitin paraprak për rreth 13 milionë denarë, siç tha drejtori. Ai supozon se ky është rezultat i inflacionit, sepse ai nuk sheh se janë shtuar pika të reja. Kjo mund të jetë tregues pak shqetësues në lidhje me Pikën 5 të Rendit të ditës, se nuk merren rregullisht mjete nga Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës e cila shkurton para të caktuara dhe kjo vazhdon për rreth 4-5 vite mëparë, që kur u hoq taksa radiodifuzive. Ai vuri në dukje se është e nevojshme të mendohet për kursime siç ishte në vitet e kaluara me krizën e Covid-it dhe të vazhdohet në atë drejtim. Do të dëshiroja që kur të largohet drejtori dhe kjo përbërje e Këshillit, Agjencia të mbetet në gjendje të mirë, që të mos vihet në situatë që të harxhohen dhe ato mjete që janë në rezervë. Diçka do të duhet të ndërmirret në lidhje me pikën 5 pasi që padyshim ka problem me financat në të gjitha anët dhe shteti dhe pushtetit vendor.

Z. Ajdini tha në fazën kur shqyrtohen si Draft-versione të tre dokumenteve, ai jep mbështetje dhe do të votojë "pro".

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2024, me tekstin e propozuar.

Agjencia në lidhje me Draft-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2024, të veprojnë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe neni 47 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-Planin vjetor të lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të sigurohet diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-Planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative për vitin 2024, me tekstin e propozuar.

Agjencia, në lidhje me Draft-Planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative për vitin 2024, të veprojnë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 47 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-Planin vjetor ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të sigurohet diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-Programin për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024 (me Draft-programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Draft-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024), me tekstin e propozuar.

Agjencia në lidhje me Draft-programin për punë të lartpërmendur, të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 47 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019.

Obligohet Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-programin e punës së lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, me qëllim që të sigurohet diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 5

Z. Trajçevski Shpjegoi informacionin për mjetet e transferuara për financimin e veprimtarisë radiodifuzive nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, me propozim - Konkluzion. Ai ka shpjeguar, siç ka thënë edhe në shpjegimin për pikat e mëparshme, të ardhurat më të mëdha Agjencia i merr nga mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive. Sipas ndryshimeve të fundit nga korriku 2023, Agjencia duhet të marrë përqindje të mjeteve për financimin e veprimtarisë radiodifuzive që janë të destinuara për të gjithë sektorin radiodifuziv dhe shuma e të cilave është 1% nga të ardhurat e realizuara të përcaktuara nga llogaria e fundit përfundimtare që është miratuar nga Kuvendi i RMV-së. Nga kjo shumë prej 1%, sipas ndryshimeve të fundit, Agjencia do të duhet të marrë 5% në vend të 6% të mëparshëm që duhej t'i merrte me ligjin e mëparshëm. Llogaria e fundit përfundimtare që është miratuar në Kuvend është për vitin 2021 dhe nëse nga kjo llogari përfundimtare mirrëntë ardhurat tatimore të realizuara 1% e tyre, gjegjësisht 5% e kësaj shume prej 1%, Agjencia duhet të marrë në vit 62 milionë e 844 mijë e 653 denarë ose e ndarë në 12 këste, në nivel mujor nga 5.237.054,00 denarë. Përkundër kësaj, nga muaji gusht kur Ligji tashmë ka hyrë në fuqi, Agjencia merr në muaj nga 4.500.000,00 denarë siç ishte në ligjin e mëparshëm, para ndryshimeve, ose çdo muaj merr më pak mjete nga 737.054,00 denarë. Me këtë për 4 muajt e fundit ka marrë më pak rreth 3 milionë denarë. Nëse kjo transferohet në dhe vitin e ardhshëm dhe mbetet kjo llogari përfundimtare e miratuar, Agjencia në bazë vjetore do të marrë më pak 9 milionë denarë, që është shumë serioze. Duke pasur parasysh faktin se me ndryshimet e fundit në LSHMAAV, është fshirë pjesa e Ligjit ku më parë, Ministri i Shoqërisë Informatike, mundej me bindjen e tij, gjegjësisht nëse nuk mblidhen mjete të mjaftueshme, ka mundur të mos i paguajë mjetet Agjencisë, tani dispozitë e tillë në Ligj nuk ekziston dhe mjetet që janë parashikuar në ligj duhet të transferohen plotësisht në Agjenci. ASHMA-ja tashmë ka njoftuar MIOA dhe ka kërkuar që në afat prej 15 ditësh të kryhet korrigjim të pagesësave që janë transferuar, por ato 15 ditë kanë skaduar dhe ende nuk ka përgjigje nga MIOA. Për këtë arsye, është propozuar që të dërgohet edhe një shkresë paralajmëruese para padisë, për të kërkuar pagesën e mjeteve. Në të kundërtën, do të ndërmerren masa para gjykatës kompetente për t'i dhënë Agjencisë mjetet që i takojnë sipas LSHMAAV.

Z. Petrushevski tha se duhet të veprohet në këtë drejtim sepse nuk mund të mbështeten në paratë e kursyera nga vitet e kaluara. Ato harxhohen lehtë nëse nuk ka prurje

të reja. Ministria në pajtim me Ligjin, siç tha drejtori, duhet t'i paguajë mjetet, por këtë nuk po e bën. Dhe llogaritjet janë për vitin 2021 dhe për 2022 buxheti është sigurisht më i madh, çdo vit rritet, që do të thotë se edhe këtu Agjencia është dëmtuar. Ai deklaroi se do të mbështesë propozimin e drejtorit për të dyja çështjet, për të dërguar paralajmërim të fundit dhe më pas për të nisur procedurë ligjore.

Z. Fidanoski tha se zgjidhja e propozuar nga drejtori Trajçevski është absolutisht e drejtë. Sipas tij, nuk lejohet që shteti, përkatësisht ministria kompetente që duhet t'i paguajë mjetet, të luajë në atë mënyrë me mjetet që është i obliguar t'i paguajë sepse ato mjete nuk i përkasin ministrisë. Ajo është përgjegjëse vetëm për transferimin e mjeteve në ASHMA për realizimin e kompetencave të saj ligjore. Ai përkujtoi se për këtë situatë ka avokuar edhe në të kaluarën, për ndryshimin e mënyrës së financimit të organit rregullator. Sistemi i mëparshëm ishte me 1% të buxhetit, ata e avokuan atë duke besuar se në këtë mënyrë do të stabilizohet financimi i Agjencisë, i domosdoshëm deri në atë masë që të ketë pavarësi financiare absolute dhe për çdo lloj pavarësie, sepse pavarësia financiare është segmenti më i rëndësishëm për qëndrueshmërinë në raport me të gjitha sferat. Agjencia 6 vite më parë, që nga aktvendimi i mëparshëm ligjor, asnjëherë nuk i ka marrë mjetet që i takonin sipas aktvendimit ligjor, pasi sipas aktvendimit të atëhershëm ligjor, nëse nuk ka mbledhje të mjeteve, mund të japin më pak. Tashmë nuk e ka edhe këtë dispozitë, mjetet janë zvogëluar, për afërsisht nga Buxheti merret 1 milion euro në vit, ndonëse ai personalisht ka vlerësuar se duke pasur parasysh shtimin e kompetencave që do të sjellin një sërë lëvizjesh dhe punësime të reja të nevojshme në Agjenci, së paku edhe një çerek i këtyre mjeteve është i nevojshëm për t'u siguruar drejtpërdrejt nga Buxheti. Agjencia dhe mjetet që i takojnë me ligj nuk i merr dhe nuk ka asnjë shpjegim pse nuk i merr. Nëse në këtë shtet ka mjete për pagesa të ndryshme, sigurisht që duhet të ketë mjete dhe për atë që është e nevojshme, ligjërisht është e detyruar, të bëjë një gjë të tillë, e kjo është të paguajë mjetet e parashikuara. Në këtë drejtim, ai tha se absolutisht pajtohet që t'i dërgohet edhe një shkresë drejtuar MIOA dhe të përkujtohet se në pajtim me ndryshimet e reja ligjore, nuk ka të drejtë diskrecionale se sa para do të paguajë, por detyrim ligjor se sa do të jetë në baza mujore.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Informacionin nr.05-4152/1, datë 09.11.2023 për transferimin e mjeteve financiare për financimin e veprimtarisë radiodifuzive nga Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe njëzëri miratoi konkluzion:

- t'i dorëzojë MIOA shkresë si paralajmërim përfundimtar para padisë për t'i paguar mjetet që i detyrohen Agjencisë në pajtim me dispozitat e ligjit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh dhe
- nëse MIOA nuk e përmbush detyrimin për pagesën e mjeteve brenda afatit të caktuar, Agjencia të iniciojë kontest juridik para gjykatës kompetente.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr.Emilija Janevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të EF-EM 90.3-SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e kryer në shtator të vitit 2023. Është shkelur neni që i referohet impresium. Në ditën e analizës tek transmetuesi, është konstatua se në disa edicione audio të "Lajme Sportive në 90.3 EF-EM" nuk është publikuar impresium. Për këto arsye, propozohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë vërejtje publike me afat

harmonizimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të konstatuar nëse i ka respektuar dispozitat e Ligjit për Media.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt administrative nr.10-3653/1 datë 04.10.2023 dhe njëzëri konkludoi që t'i shqiptohet masë vërejtje publike EF-EM 90.3 SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media sepse më 5 Shtator 2023, si në shpicën lajmëruese dhe në shpicën çlajmëruese nuk i publikoi të dhënat për impresium në tërësinë e lajmeve në radio, me titull: "Lajmet sportive në 90.3 EF-EM".

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, obligohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr. Emilija Janevska, ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike Shërbimit të pestë programor televiziv (TVM5) të NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup, për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ajo shpjegoi se me mbikëqyrjen e rregullt të shërbimeve programore të shërbimit publik radiodifuziv të realizuar në tetor të vitit 2023, është konstatuar se TVM5 nuk ka respektuar obligimin për transmetimin e veprave audiovizuale maqedonase. Nga mbikëqyrja është konstatuar se në vend të 40%, ai ka transmetuar 37% vepra audiovizuale maqedonase, që është 41 minuta e 45 sekonda më pak se detyrimi ligjor. Për këto arsye, sugjerohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë vërejtje publike me afat harmonizimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse ka respektuar dispozitat e LSHMAAV. Ai ka theksuar se TVM5 ka dërguar deklaratë ku thuhet se e kanë shqyrtuar raportin dhe kanë konstatuar se pa dashje është bërë mbikëqyrje dhe se shkelja është mënjanuar.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore, nr.10-3912/1, datë 27.10.2023 dhe njëzëri konstatoi që Shërbimit të pestë programor televiziv të Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - TVM5 t'i shqiptoj masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 5 tetor 2023 nuk ka transmetuar së paku 40% programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga data e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit. Ajo shpjegoi se në objektin e punës ku ndodhet selia e ASHMA-së dhe Agjencia për Rini dhe Sport, është instaluar sistemi i ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit. Është e nevojshme të mirëmbahet rregullisht, veçanërisht në dhomën e serverit ku ndodhet TIK pajisja. Për këto arsye është e nevojshme të zbatohet ky furnizim publik i cili është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe meqenëse kontrata e rezultuar është planifikuar të jetë për 2 vjet, mjetet janë siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, dhe të njëjtat do të sigurohen më tej në Planin financiar të Agjencisë për vitin 2024 dhe 2025. Ky furnizim do të zbatohet si furnizim grupor dhe sipas mjeteve të parashikuara do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar me shpallje të konkursit në sistemin elektronik të furnizimit publik në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, dhe të njëjtit do të parashihen në Planin financiar të Agjencisë për vitin 2024 dhe 2025.

Pika 9

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbime shtypi (printimi). Ajo shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim të rregullt që kryhet çdo vit. Kontrata që do të rezultojë do të lidhet për periudhë prej një viti. E njëjta do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët duke u publikuar si njoftim në sistemin elektronik për furnizime publike.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbime printimi (shtypshkronje).

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Shërbime printimi (shtypshkronje) është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.

Pika 10

Udhëheqësja Mitrevska e shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim i mendimit të publikut. Ajo ka shpjeguar se ky furnizim do të realizohet si procedurë e hapur e thjeshtuar duke respektuar dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Do të publikohet njoftimi në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Ajo tha se si për të gjitha furnizimet e tjera, dhe për këtë furnizim të dhënat e tjera gjenden në materialet e dorëzuara sipas pikës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim i mendimit të publikut.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Hulumtim i mendimit të publikut është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.

Pika 11

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të marrë Vendim me të cilin miraton mjetet financiare në vlerë prej 50.000,00 denarë pa TVSH (59.000,00 denarë me TVSH), për furnizim me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligji për furnizim publik - për shërbimin: trajnimi i 10 (dhjetë) personave të punësuar në Shërbimin profesional të Agjencisë, të cilët janë përfshirë në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kritereve për përcaktim të aftësive.

Për realizimin e shërbimit të lartpërmendur, mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.

Pika 12

Z. Petrushevski, lidhur me Propozimin për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 2 (dy) qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të dispozitave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", tha se ka një vërejtje teknike. Në kërkesën nga sektori janë cekur emrat konkret të punonjësve që do t'i përdornin këto qasje. Ai llogarit se për arsye praktike nuk është mirë të definohen punonjës konkret ose dhe kushdo i punësuar. Sugjeroi nëse është e mundur, nëse ligji lejon, që shërbimi IT të bëjë dy qasje "sluzbenvesnik1@avmu.mk" dhe "sluzbenvesnik2@avmu.mk" dhe atëherë çdo punonjës që ka lidhje me këtë punë, nëse rastësisht shkon në pushim mjekësor, të mund të përdoret

nga dikush tjetër por pa u keqpërdorur. Nëse kështu lidhet me email individual të të punësuarit, do të jetë problem sepse do të jetë e nevojshme që t'i jepni atij fjalëkalimin për të hyrë nëse ai nuk është prezent.

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se qasja në Gazetën Zyrtare të RMV-së në bazën elektronike të rregulloreve është e lidhur me kompjuterin personal kështu që nëse punonjësi mungon, mund një tjetër të kërkojë, domethënë nuk është i lidhur vetëm me një punonjës nga sektori.

Z. Petrushevski tha gjithësesi duhet menduar që në të ardhmen të ketë një kompjuter vetëm për këtë qëllim dhe të përdoret nga të punësuarit sipas nevojës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për miratimin e mjeteve financiare në shumë prej 22.000,00 denarë me TVSH të llogaritur prej 18% për rinovimin e 2 (dy) qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të rregulloreve të “Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.

Shuma e mjeteve për qasje në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve të “Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” është paraparë në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 13

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-4077/13

16.11.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**